



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



PLANI STRATEGJIK I ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT 2018 – 2021

Prishtinë
2018

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

FAKTET KRYESORE

E THEMELUAR MË

2003

E THEMELUAR NGA

MISIONI I ADMINISTRATËS SË
PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË
BASHKUARA NË KOSOVË (UNMIK)

AUDITORËT
NDËRKOMBËTARË

- INGA-BRITT AHLENIUS (2003)
- LINDA CASELLA (2006)
- LAGE OLOFSSON (2009)

AUDITORI I PARË
KOSOVAR

- BESNIK OSMANI
I EMËRUAR NGA KUVENDI I
KOSOVËS, MË 31 MARS 2016

AUDITIMET

- ÇDO VIT:
- ✓ MBI 100 RAPORTE TË AUDITIMIT
 - ✓ MBI 1000 REKOMANDIME

UEBFAQJA

<http://www.zka-rks.org>

PROFILI I ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Historiku

Rregullorja 2002/18 mbi themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është shpallur nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u), më 4 tetor të vitit 2002.

Në nëntor të vitit 2003, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), emëroi Auditorin e parë të Përgjithshme të Kosovës, znj. Inga-Britt Ahlenius, për një mandat tre vjeçar. Megjithatë, raportet e auditimit ende hartoheshin nga Gjykata Holandeze e Auditimit, e kontraktuar nga UNMIK-u, ndërsa stafi i ZAP-it ndihmonte procesin e auditimit.

Në vitin 2006, UNMIK-u emëroi znj. Linda Casella si pasardhëse të znj. Ahlenius. Gjatë mandatit të znj. Casella, raportet e auditimit u përgatitën kryesisht nga stafi lokal i ZAP.

Në vitin 2008, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm (AP) është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe është miratuar Ligji nr. 03/L-075 për "Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës".

Në vitin 2009, z. Lage Olofsson, ishte emëruar Auditori i Përgjithshëm i tretë i Kosovës. Ai u emërua nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (njëkohësisht Përfaqësues Civil Ndërkombëtar dhe udhëheqës i Zyres Civile Ndërkombëtare në Kosovë).

Në mars të vitit 2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës emëroi z. Besnik Osmani si Auditorin e parë të Përgjithshëm kosovar, i cili u emërua përmes një procesi të hapur dhe konkurrues, me nominim të Presidentes së Kosovës. Në qershor të vitit 2016, Kuvendi shpalli Ligjin e ri nr. 05/L-055 për AP dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke zëvendësuar kështu ligjin e vjetër.

Mandati

Në përputhje me Kushtetutën, Auditori i Përgjithshëm (AP) është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Kosovës. AP ushtron funksionet e tij në bazë të ligjit dhe është i pavarur në aspektin funksional, financiar dhe operacional në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tij. AP i raporton Kuvendit të Kosovës.

AP ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve. AP kryen auditime të rregullsisë së Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore, si dhe Ndërmarrjeve Publike. Ai gjithashtu kryen auditime të performancës. AP ka të drejtë t'i përcjellë fondet publike deri te përfituesit e fundit.

AP ushtron mandatin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA-të).

Aktiviteti i auditimit dhe burimet njerëzore

Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA) harton dhe dorëzon në Kuvend dhe tek subjektet e audituara, mbi 100 raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performancës.

Mbi 1000 rekomandime të auditimit jepen çdo vit për organizatat buxhetore.

Të gjitha raportet e auditimit bëhen publike.

Aktualisht, ZKA ka të punësuar 160 punonjës, 130 prej të cilëve janë staf auditues.

TABELA E PËRMBAJTJES

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm	6
1. Preambula	7
2. Partnerët strategjik	8
3. Analiza e mjedisit dhe identifikimi i sfidave dhe boshllëqeve	10
4. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e ZKA-së	11
5. Qëllimet dhe objektivat strategjike	13
5.1. Qëllimi 1: Pavarësia dhe standardet profesionale	15
5.2. Qëllimi 2: Qeverisja dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale.....	17
5.3. Qëllimi 3: Komunikimi, ndikimi, integrimi.....	20
6. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Planit strategjik.....	23
Shtojca 1: Raporti i boshllëqeve	25
Shtojca 2: Fjalori i shprehjeve	36

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë dhe partnerë të Zyres Kombëtare të Auditimit,

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes para jush Planin Strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për tri vitet e ardhshme: 2018 – 2021.



Ndonëse institucion i ri për nga mosha (këtë vit feston 15 vjetorin e saj), Zyra Kombëtare e Auditimit vlerësohet nga partnerët vendor dhe ndërkombëtar si njëri ndër institucionet më kredibile në vend. Ky vlerësim e shton përgjegjësinë time dhe të kolegëve të mi që të përmbushim mandatin tonë kushtetues e ligjor me integritet dhe profesionalizëm të lartë.

Krahas vendosmërisë për të kryer punën audituese në mënyrë të pavarur, ne i kushtojmë vëmendje të veçantë edukimit të vazhdueshëm profesional dhe adaptimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira të auditimit që zhvillohen nga

organizatat profesionale ndërkombëtare të auditimit.

Duke qenë të vëmendshëm për zhvillimet dhe sfidat që na presin gjatë tri viteve të ardhshme, me qëllim që të jemi në gjendje t'i përballojmë me sukses këto sfida dhe të përmbushim misionin dhe ambicjet tona institucionale, Zyra Kombëtare e Auditimit ka hartuar planin e ri strategjik tre-vjeçar. Me këtë plan kemi përcaktuar tri qëllime kryesore:

1. Të përmbushim misionin kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA);
2. Të zhvillojmë dhe të forcojmë kapacitetin institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative; dhe
3. Të zhvillojmë dhe të mirëmbajmë marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Ne besojmë që realizimi i këtyre qëllimeve do ta ndihmoj Zyrën Kombëtare të Auditimit të shtoj edhe më tej kredibilitetin institucional për të kryer misionin e saj në mënyrë të pavarur dhe objektive dhe për të përmbushur pritjet e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Prishtinë, 1 shtator 2018

1. PREAMBULA

15 VITE TË ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Institucion kredibil dhe i përgjegjshëm në shërbim të interesave të qytetarëve

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm u themelua 15 vite më parë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u). Në atë kohë, sapo ishin krijuar institucionet e përkohshme të Kosovës dhe ato udhëhiqeshin bashkërisht nga zyrtarët vendorë e ndërkombëtarë. Me rritjen e numrit të institucioneve dhe zgjerimin e përgjegjësiave të tyre, si dhe me rritjen e buxhetit kombëtar, u shfaq nevoja për krijimin e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm me qëllim që t'u ofrohet qytetarëve transparencë në shpenzimin e parasë publike. Duke qenë njëri prej institucioneve më të rëndësishme në vend, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës ishte për më shumë se 10 vite ndërkombëtar. Auditori i parë i Përgjithshëm Kosovar u emërua në mars të vitit 2016.

Përderisa, substanca e angazhimit të institucionit të Auditorit të Përgjithshëm ka mbetur konsistente me kalimin e viteve, plani i ri strategjik paraqet një mënyrë të re, më të avancuar të punës që është më e qartë në qëllimet dhe objektivat strategjike, më e integruar dhe që i ofron mundësinë Zyres Kombëtare të Auditimit (ZKA) që t'i përgjigjet pritjeve të palëve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.

Për përgatitjen e këtij plani, ZKA ka ndërmarr një sërë aktiviteteve me palët e brendshme dhe të jashtme. Është bërë skanimi i gjendjes ekzistuese, përmes konsultimit me palët e interesit dhe studimit të shumë dokumenteve paraprake, të përgatitura në bashkëpunim me partnerët tonë. Ky angazhim që ka rezultuar me një raport përmbledhës të sfidave dhe boshllëqeve, ka dëshmuar që ZKA ka nevojë të zhvillojë më tej kapacitetet institucionale dhe të aplikoj një qasje të hapur ndaj ndryshimit. Kjo do t'i mundësojë asaj që të qeverisë në mënyrë më efektive dhe t'i përgjigjet pritjeve dhe kërkesave të së ardhmes.

Së këndejmi, duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri, ndryshimet në menaxhmentin e lartë të institucionit, si dhe trendët në zhvillim si në vend ashtu edhe në botë (përsa i përket fushës së auditimit të jashtëm), Auditori i Përgjithshëm vendosi që të hartojë një plan të ri strategjik, në vend se ta rishikoj planin ekzistues. Ndonëse ekzistojnë mundësitë reale për përmirësimin e punës sonë, gjatë tri viteve të ardhshme, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm do të përballet paralelisht edhe me sfidat që janë evidente si në vendin tonë, ashtu edhe në tërë rajonin. Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) me të drejtë ka shfaqur shqetësimet e saj se “si do të arrijnë ISA-të të ruajnë legjitimitetin e tyre në kohën kur ka rënie të besimit në institucionet publike?” dhe “si mundën ISA-të të ndihmojnë në kthimin e besimit të publikut në sektorin publik?”.

Ndonëse, ZKA është vlerësuar pozitivisht nga organizatat e ndryshme rajonale e ndërkombëtare¹, sfidat e sipërpërmendura kërkojnë një ndërveprim institucional me të gjithë partnerët strategjik dhe palët e interesit. Rrjedhimisht, ky plan strategjik ka për qëllim që t'u ofroj të gjithë partnerëve vizionin, misionin, vlerat, qëllimet dhe objektivat strategjike të ZKA-së për tri vitet e ardhshme. ZKA është e dedikuar që të ofrojë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, të ndihmojë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit përmes rekomandimeve praktike dhe konstruktive. ZKA bën ftesë publike për bashkëpunim, duke synuar të jetë organizatë shembull.

¹ Raporti Barometri i Ballkanit (2017), i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), tregon që 48% e qytetarëve pajtohen që ZKA është e pavarur nga ndikimi politik dhe rangon ZKA-në në pozitën e dytë në rajon, ku mesatarja është 31%; ndërsa 67% e tyre pajtohen që ZKA mund të ndikoj që ta bëjë qeverinë më të përgjegjshme në shpenzimin e parasë publike.

2. PARTNERËT STRATEGJIK

Pritshmëritë e qytetarëve, të Kuvendit, të Qeverisë dhe të palëve tjera të interesit janë të larta për rezultatet e ZKA-së, në përputhje me mandatin e saj kushtetues e ligjor. Marrëdhëniet e ZKA-së me partnerët strategjik dhe palët e interesit janë të mira dhe konstruktive. ZKA mban kontakte me:

- Kuvendin (komisionet parlamentare, në veçanti: Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa (KBF));
- Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Mediat;
- Ekzekutivin dhe subjektet e audituara: ministritë, agjencitë e pavarura, komunitat, NP-të, etj;
- Institucionet e zbatimit të ligjit, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Avokatin e Popullit;
- Partnerët profesional (ISA-të homologe dhe organizatat profesionale rajonale dhe ndërkombëtare të ISA-ve, donatorët, institucionet akademike, shoqatat profesionale, etj).

1. Partneriteti me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile dhe mediat

ZKA zhvillon komunikim me qytetarët nëpërmjet partneritetit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), përmes të cilave atyre u ofrohet mundësia dhe qasja e plotë për të kontribuar në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së zyrtarëve publik. Qytetarët janë të interesuar të dijnë nëse burimet kombëtare po përdoren në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive dhe që vlera e kontributeve të tyre po maksimizohet. Meqë kjo përkon me misionin e ZKA-së, partneriteti me qytetarin është i një rëndësie vitale për të përmbushur pritshmëritë e taksapaguesve për një qeverisje efektive dhe shërbime publike efikase. Në funksion të informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve ZKA organizon konferenca dhe njoftime për media dhe publikon në uebfaqen e saj të gjitha produktet e auditimit dhe informatat që janë në interes për publikun e gjerë.

2. Përkrahja dhe llogaridhënia ndaj Kuvendit

Kuvendi i Republikës së Kosovës është partneri kryesor institucional i Auditorit të Përgjithshëm. Në funksion të përmbushjes së plotë të obligimeve kushtetuese e ligjore, duke pasur si qëllim rritjen e llogaridhënies në institucionet publike dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit, ZKA i ofron Kuvendit gjithë përkrahjen e nevojshme. ZKA do të vazhdojë me përgatitjen e përmbledhjeve të raporteve individuale të auditimit për nevoja të komisioneve parlamentare, si dhe do të intensifikojë pjesëmarrjen në takimet e komisioneve parlamentare, në veçanti të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe do të ofrojë këshilla dhe sqarime të nevojshme për anëtarët e komisioneve të Kuvendit për çështjet e evidentuara në raportet e auditimit.

3. Komunikimi me ekzekutivin dhe subjektet tjera të audituara

Komunikimi me ekzekutivin dhe subjektet tjera të audituara fokusohet në planifikimin, ekzekutimin, raportimin dhe përcjelljen e auditimeve individuale si dhe auditimin e buxhetit të shtetit. Kryerja e aktiviteteve audituese kërkon një ndërveprim si me funksionet e pushtetit qendror ashtu edhe me atë lokal. Komunikimi më intensiv ndodhë me Ministrinë e Financave si institucioni përgjegjës për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe për sigurimin e kuadrit të nevojshëm për menaxhimin financiar dhe kontrollin. ZKA pranon informatat e nevojshme nga subjektet e audituara të cilat gjithashtu dorëzojnë pasqyrat e tyre financiare, sipas afatit ligjor. Organizatat e audituara buxhetore përgatisin planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së. KMFP kërkon nga organizatat të raportojnë se si janë zbatuar rekomandimet. Në raste të caktuara raportet e auditimit dërgohen për shqyrtim në seancë plenare të Kuvendit. Sidoqoftë, shkalla e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është e kënaqshme.

4. Bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë

Në raport me organet e drejtësisë Auditori i Përgjithshëm vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale. Institucioni i Auditorit të Përgjithshëm do të vazhdojnë bashkëpunimin ndër-institucional me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit. Në këtë kuadër do të koordinohen veprimet lidhur me detyrimet e përcaktuara ligjore me: Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke e informuar në lidhje me rastet indikative me elemente të veprave penale të cilat hasen gjatë punës audituese; Policinë e Kosovës, duke i ofruar të dhëna dhe dokumente relevante të siguruar në proceset e auditimit për rastet e caktuara të cilat trajtohen nga hetuesia; Agjencinë Kundër Korrupsionit, duke i ofruar informata shitesë dhe sqarime sipas nevojës lidhur me trajtimin e të gjeturave në raportet e auditimit; Avokatin e Popullit, duke bashkëpunuar për rastet që mund të jenë subjekt i shkeljes së të drejtave të njeriut, etj.

5. Bashkëpunimi me partnerët profesional

ZKA ka raporte të mira pune me partnerët profesional: ISA-të, donatorët, institucionet akademike, shoqatat profesionale, etj. ZKA ka marrëveshje trevjeçare me Zyren Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO), e cila përfshinë ngritjen e kapaciteteve profesionale të ZKA-së në disa fusha. Poashtu, ZKA ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimin me ISA të Turqisë, të Uellsit dhe të Shqipërisë. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve do të zhvillohen aktivitete të përbashkëta që kanë për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe ngritjen e mëtejme të kapaciteteve institucionale të ZKA-së.

ZKA bashkëpunon ngushtë edhe me donatorët në Kosovë, si Zyren e Bashkimit Evropian, USAID-in, Bankën Botërore, GIZ-in, Zyren Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, OSBE-në, etj. ZKA bashkëpunon edhe me shoqatat profesionale për certifikimin e auditorëve financiar si dhe institucionet akademike në Kosovë.

ZKA merr pjesë në aktivitetet e Rrjetit të ISA-ve të vendeve jo-anëtare të BE-së dhe Gjykatës Evropiane të Auditimit (ECA) si dhe të Komitetit të Kontaktit (ISA-të e vendeve anëtare të BE-së). Poashtu, ZKA ka vendosur bashkëpunimet e para edhe me Institucionin Suprem të Auditimit të SHBA-ve (GAO). Sidoqoftë, ZKA ende nuk është anëtare e institucioneve ndërkombëtare dhe rajonale të auditimit për sektorin publik, si ONISA (INTOSAI) dhe EUROSAI². Së këndejmi, anëtarësimi në këto organizata është njëri prej qëllimeve strategjike të saj.

Obligimet e ZKA-së me Marrëveshjen për Stabilizim Asociim

ZKA në vazhdimësi zhvillon aktivitete që fokusohen në zbatimin e prioriteteve kryesore që ndërlidhen me Kapitullin 32 (Kontrolli financiar) të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA) që kanë për qëllim fuqizimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe entiteteve të sektorit publik. Rrjedhimisht, aktivitetet e planifikuara gjatë tri viteve të ardhshme janë të ndërlidhura me realizimin e objektivave strategjike të ZKA-së.

² Përfaqësues të Institucionit të Auditorit të Përgjithshëm kanë marrë pjesë në punimet e Kongresit të 22-të të Organizatës Ndërkombëtare të ISA-ve ONISA (INCOSAI 2016) dhe të Kongresit të 10-të të Organizatës Evropiane të ISA-ve – EUROSAI (2017), në cilësinë e vëzhguesit.

3. ANALIZA E MJEDISIT DHE IDENTIFIKIMI I SFIDAVE DHE BOSHLLËQEVE

Gjatë tri viteve të ardhshme, disa prej zhvillimeve dhe sfidave të rëndësishme për Kosovën në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar pritet të jenë: zhvillimi ekonomik, forcimi i rendit dhe ligjit, stabiliteti politik dhe institucional, lufta kundër korrupsionit, integrimi evropian, pranimi ndërkombëtar, etj.

Brenda këtij konteksti, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), përkatësisht Ekipi për Planifikim Strategjik (EPS), duke u bazuar në Doracakun për Planifikim Strategjik për Institucionet Supreme të Auditimit, të zhvilluar nga Iniciativa për Zhvillim e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (e njohur si "IDI"), ka bërë vlerësimin e nevojave, përkatësisht definimin e gjendjes momentale në ZKA duke e krahasuar me gjendjen e dëshirueshme (p.sh. praktikat më të mira ndërkombëtare/rajonale, vizioni për të ardhmen, etj). Pra, është bërë diagnostifikimi i gjendjes ekzistuese dhe janë identifikuar sfidat, boshllëqet dhe nevojat e ZKA-së.

Ky aktivitet ka përfshirë konsultimin e një numri të palëve: të brendshme (personeli, sindikata dhe menaxhmenti i ZKA-së) dhe të jashtme (deputetë, OSHC, etj) përmes intervistave të drejtpërdrejta apo duke përdorur pyetësorë sipas fushave. Ekipi poashtu ka analizuar edhe dokumentet paraprake që janë përgatitur nga personeli i ZKA-së, në bashkëpunim me Zyren Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe të Britanisë së Madhe. Si rezultat i këtij procesi, është hartuar një raport përmbledhës i boshllëqeve në të cilin janë identifikuar të gjitha sfidat e rëndësishme dhe shkaqet e tyre. Ky dokument ka shërbyer si bazë për diskutimet në lidhje me vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike që janë përfshirë në Strategjinë tri vjeçare të ZKA-së.

Analiza e gjendjes është fokusuar në fushat në vijim: (1) Pavarësia dhe korniza ligjore; (2) Burimet njerëzore; (3) Metodologjia dhe standardet e auditimit; (4) Qeverisja e brendshme dhe etika; (5) Përkrahja korporative; (6) Marrëdhëniet me palët e interesit; dhe (7) Rezultatet.

Raporti i boshllëqeve nënvizon një numër çështjesh të cilat kërkojnë vëmendjen e menaxhmentit të institucionit të Auditorit të Përgjithshëm dhe përkrahjen e partnerëve dhe të palëve të interesit në mënyrë që të arrihen zgjidhje efektive dhe të qëndrueshme.

Në **Shtojcën 1** janë prezantuar gjetjet kryesore nga ky aktivitet.

Kontributi i ZKA-së në reformat për Menaxhimin e Financave Publike

Zyrtarët e ZKA-së kanë marrë pjesë aktive në grupin punues për "Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike" në të cilin janë të përfshirë të gjithë aktorët e rëndësishëm të fushës si dhe donatorët. ZKA do të vazhdojë të ofrojë përkrahjen e saj për aktivitetet e parapara në kuadër të Strategjisë, që synojnë rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit dhe rrjedhimisht rritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve në shpenzimin e parasë publike dhe avancimin e qeverisjes në institucionet publike. Megjithatë, ZKA do të ruaj me kujdes pavarësinë e saj institucionale dhe nuk do të përfshihet në vendime menaxheriale të qeverisë apo të subjekteve tjera të audituara.

4.

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

4. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

VIZIONI

“Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve”

MISIONI

“Përmes auditimeve cilësore fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare”

VLERAT E ZKA-SË

<i>Pavarësia</i>	Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t’i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.
<i>Profesionalizmi</i>	ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.
<i>Integriteti</i>	ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet jashtë çdo konflikti interesi.
<i>Transparenca</i>	ZKA është organizatë e hapur dhe do t’i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t’i ofroj publikut të gjerë informacionin e përftuar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

5.
QËLLIMET STRATEGJIKE

5. QËLLIMET STRATEGJIKE

1.

PAVARËSIA DHE STANDARDET PROFESIONALE

Të përmbush misionin
kushtetues e ligjor
duke kryer auditime relevante,
në përputhje me SNISA

2.

QEVERISJA DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Të zhvilloj dhe të
forcoj kapacitetin
institucional për të
mbështetur auditimin
dhe qeverisjen
korporative

3.

KOMUNIKIMI, NDIKIMI DHE INTEGRIMI

Të zhvilloj dhe të
mirëmbaj
marrëdhënie të mira
me palët e jashtme,
duke promovuar
auditimin, rritur
ndikimin dhe duke u
integruar në
organizatat globale
dhe rajonale të ISA-
ve

5.1 QËLLIMI STRATEGJIK 1

**PAVARËSIA DHE
STANDARDET PROFESIONALE**

1.

Të përmbush misionin kushtetues e ligjor duke kryer auditime relevante, në përputhje me SNISA

#	Objektivat strategjike	Rezultatet e pritshme – treguesit e performancës
1	Të forcoj pavarësinë dhe mandatin në përputhje me SNISA-të, përfshirë ndryshimet e nevojshme legislative	<ul style="list-style-type: none"> Legjislacioni relevant për ZKA-në është ndryshuar, në përputhje me SNISA-të. Ndryshimet janë bërë posaçërisht në pajtim me Deklaratën e Limas dhe të Meksikos.
2	Të avancoj metodologjinë e auditimit dhe sistemet e kontrollit të cilësisë për të siguruar cilësinë e auditimit sipas SNISA-ve, përfshirë automatizimin e auditimit	<ul style="list-style-type: none"> Doracaku për auditime të rregullsisë (auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë) dhe të performancës, përfshirë pakon përkatëse të letrave të punës si dhe Udhëzuesin për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim (të rregullsisë & të performancës) janë përditësuar, në pajtueshmëri me SNISA. Auditimet e pajtueshmërisë janë ndarë nga auditimet financiare dhe ka filluar dhënia e opinionit të veçantë për auditime të pajtueshmërisë. Softueri për automatizim të auditimeve është instaluar dhe ka filluar përdorimi i tij nga personeli auditues.
3	Të përmirësoj cilësinë dhe të rris portofolion e auditimeve të performances (përfshirë auditimet e TI-së) dhe të ndërmarrjeve publike	<ul style="list-style-type: none"> Është rritur numri i auditimeve të performancës për çdo vit me nga dy auditime. Është rritur numri i auditimeve të ndërmarrjeve publike për çdo vit me nga tri auditime. Raportet e ZKA-së vlerësohen pozitivisht nga palët e jashtme.
4	Të zhvilloj qasjen për përzgjedhjen e auditimeve relevante, bazuar në rrezik	<ul style="list-style-type: none"> Është zhvilluar dhe ka filluar së zbatuari një kornizë për përzgjedhjen e auditimeve relevante, bazuar në rrezik, në përputhje me SNISA-të.

5.2 QËLLIMI STRATEGJIK 2

**QEVERISJA DHE ZHVILLIMI I
KAPACITETEVE INSTITUCIONALE**

2.

Të zhvilloj dhe të forcoj kapacitetin institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative

#	Objektivat strategjike	Rezultatet e pritshme – treguesit e performancës
1	Të zhvilloj më tej aftësitë menaxheriale, përfshirë zhvillimin e sistemeve dhe të strukturave të përshtatshme organizative për të siguruar qeverisje efektive dhe efikase	<ul style="list-style-type: none"> • Janë zhvilluar kapacitetet e brendshme për planifikim strategjik dhe menaxhim të ndryshimit, përmes organizimit të programeve adekuate të trajnimit, për çdo vit. • Është zhvilluar një strukturë organizative që përkrah përmbushjen e objektivave strategjike. • Është krijuar një sistem modern për menaxhimin e informatave, përfshirë azhurnimin e sistemit ekzistues për menaxhimin e burimeve njerëzore.
2	Të siguroj burimet njerëzore për të përkrahur rritjen e portofolios së auditimeve dhe të rris kapacitetin profesional të personelit	<ul style="list-style-type: none"> • Është rritur numri i auditorëve të rregullsisë për së paku 10 në 3 vitet e ardhshme; si dhe është rritur numri i auditorëve të performancës për çdo vit me nga dy auditorë (përmes rekrutimit të brendshëm apo të jashtëm). • Janë ngritur kapacitetet profesionale (përfshirë rekrutimin e personelit të nevojshëm) për identifikimin dhe raportimin e mashtrimit dhe korrupsionit, gjatë procesit të auditimit. • Është bërë ndërlidhja e rezultateve të vlerësimit individual të performancës (identifikimi i nevojave individuale për përmirësim) me dizajnimin e planeve të trajnimit. • Shumica e auditorëve të performancës kanë ndjekur dhe përfunduar me sukses programin përkatës të edukimit profesional. • Të gjithë auditorët e TI-së kanë ndjekur së paku një trajnim adekuat, çdo vit. • Të gjithë nëpunësit civil kanë ndjekur trajnimet e dizajnuara për shërbyesit civil. • Të gjithë punonjësit e rinj kanë ndjekur trajnimet për fillestarë.

		<ul style="list-style-type: none"> • Brenda tri viteve të ardhshme janë identifikuar dhe trajnuar trajnerët në fushat me prioritet. • Është përgatitur dhe ka filluar së zbatuari politika për dërgimin e personelit në trajnim jashtë vendit.
3	Të avancoj kornizën rregullative për menaxhimin dhe vlerësimin e performancës së personelit	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e re për Vlerësimin e Performancës së personelit është aprovuar dhe ka filluar përdorimi nga fillimi i sezonit të ri auditues.
4	Të zhvilloj një komunikim të strukturuar dhe relevant brenda institucionit	<ul style="list-style-type: none"> • Është përgatitur dhe zbatuar politika për komunikim të brendshëm. • Është azhurnuar Intraneti dhe përdoret nga i tërë personeli. • Buletini mujor është përgatitur dhe shpërndarë rregullisht.
5	Të forcoj kontrollet e brendshme për të siguruar cilësinë e proceseve të ZKA-së	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti për rreziqet dhe plani i veprimit për adresimin e tyre janë përgatitur dhe kanë filluar së zbatuari. • Janë hartuar dhe kanë filluar së zbatuari Strategjia dhe plani i veprimit për TI. • Personeli është njoftuar dhe ka kuptuar funksionimin e sistemit të kontrolleve të brendshme – është zvogëluar numri i gabimeve dhe ankesave. • Doracakët dhe procedurat për menaxhimin e pasurive jo-financiare janë hartuar dhe zbatohen nga personeli. • Është funksionalizuar plotësisht sistemi për administrimin e dokumenteve zyrtare.
6	Të siguroj mbështetje teknike dhe hapësirë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për punë	<ul style="list-style-type: none"> • Është vendosur personeli në një objekt më të përshtatshëm për punë. • Është rritur flota e mjeteve të transportit, për të përmbushur nevojat e domosdoshme, së paku nga një në tri vitet e ardhshme. • Janë siguruar mjetet e domosdoshme të punës për secilin punonjës dhe është bërë ripërtirja e tyre sipas afateve optimale.
7	Të shtoj kujdesin për mirëqenien e personelit	<ul style="list-style-type: none"> • Është hartuar dhe ka filluar së zbatuari programi për të rritur mirëqenien e personelit. • Janë organizuar së paku dy herë në vit aktivitete sociale, rekreative dhe profilaktike që përfshijnë shumicën dërmuese të personelit.

5.3 QËLLIMI STRATEGJIK 3

**KOMUNIKIMI, NDIKIMI DHE
INTEGRIMI**

3.

Të zhvilloj dhe të mirëmbaj marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të ISA-ve

#	Objektivat strategjike	Rezultatet e pritshme – treguesit e performancës
1	Të zhvilloj një komunikim efektiv me palët e jashtme dhe publikun	<ul style="list-style-type: none"> • Është hartuar dhe ka filluar së zbatuari Strategjia për komunikim efektiv me palët e jashtme dhe publikun. • Është funksionalizuar Forumi konsultativ me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat. • Është rritur numri i raportimeve mediale për produktet e ZKA-së. • Është rritur numri i referencimeve në produktet e ZKA-së nga palët e jashtme. • Janë angazhuar burimet e nevojshme njerëzore për komunikim me publikun.
2	Të thelloj bashkëpunimin me Kuvendin dhe Komisionet parlamentare me qëllim të rritjes së llogaridhënies në sektorin publik	<ul style="list-style-type: none"> • Është rritur numri i raporteve të auditimit që diskutohen në komisionet parlamentare. • Është rritur shkalla e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet e audituara.
3	Të rris ndikimin përmes auditimeve përcjellëse dhe krijimit të mekanizmave efektivë për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit	<ul style="list-style-type: none"> • Është përgatitur dhe publikuar Raporti për vlerësimin e progresit në zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të performances, në fushat me rrezik të lartë. • Është zhvilluar dhe publikuar në uebfaqen e ZKA-së baza e të dhënave në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve financiare nga entitetet e audituara. Është bërë përditësimi i saj në kohë reale. • Është rritur shkalla e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet e audituara.

4

Të marr pjesë aktive dhe të integrohet në organizatat globale dhe ato rajonale

- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit.
- Anëtarësimi në INTOSAI para Kongresit të 23-të (2019).
- Anëtarësimi në EUROSAI para Kongresit të 11-të (2020).
- Sigurimi i statusit të anëtarit me të drejta të plota në Rrjetin e ISA-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për BE dhe ECA.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me ISA-të, së paku një në vit dhe zbatimi i programit të aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese.

6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT STRATEGJIK

Për **zbatimin** e Planit strategjik do të hartohen **plani vjetor i auditimit** (për sezonin e auditimit 1 shtator – 31 gusht) dhe **plani operativ njëvjeçar** (sipas vitit kalendarik).

Plani vjetor i auditimit përfshinë informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditori i Përgjithshëm për sezonin auditues. Ndërsa, plani operativ përfshinë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin dhe burimet e financimit, rezultatet, rreziqet, etj. Ky plan përveç projekteve të ndërlidhura me Planin strategjik, duhet të përfshijë edhe çështje operative të cilat duhet të planifikohen.

Gjatë zbatimit të Planit strategjik është i domosdoshëm **monitorimi** i tij. Ky është një proces që kërkon përcjelljen e vazhdueshme të projekteve dhe aktiviteteve që kanë për qëllim përmbushjen e objektivave strategjike dhe arritjen e rezultateve të dëshirueshme. Kjo i ndihmon ZKA-së që të ndërmarrë veprimet parandaluese apo korrigjuese atëherë kur zhvillimet nuk janë duke ndodhur në përputhje me planin apo edhe për shkak të ndryshimeve në ambientin e jashtëm. Monitorimi do të bëhet nga strukturat përkatëse menaxheriale të ZKA-së.

Përveç kësaj, ZKA do të bëjë edhe **vlerësimin** e zbatimit të Planit strategjik për të matur shkallën e performancës në raport me treguesit e performancës. Vlerësimi i Planit do të bëhet nga një ekip i autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm.



SHTOJCAT

SHTOJCA 1: RAPORTI I BOSHLLËQEVE

FUSHA 1. PAVARËSIA DHE KORNIZA LIGJORE

Ky domen ka dy elemente: A) Pavarësinë dhe B) Mandatin.

1.1 Gjendja e dëshirueshme

ISA qeveriset nga një kornizë ligjore që *garanton* pavarësinë dhe mandatin e saj, ashtu siç është përcaktuar në SNISA 1 (Deklarata e Limës), SNISA 10 (Deklarata e Meksikos) dhe SNISA 11 (Udhëzues dhe Praktikant e mira të INTOSAI lidhur me pavarësinë e ISA).

1.2 Boshllëqet e identifikuar

A. PAVARËSIA

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
<p>1. Pavarësia financiare: <i>Rregullimi ligjor për aprovimin dhe menaxhimin e buxhetit të ZKA-së jo në përputhje të plotë me kërkesat e SNISA</i></p> <p>2. Pavarësia funksionale: <i>Rregullimi dualist ligjor i marrëdhënies së punës për personelin e ZKA-së paraqet një pengesë për funksionimin efikas</i></p>	<p>Procesi i përgatitjes së buxhetit për ZKA-në është i njëjtë sikurse për organizatat tjera buxhetore dhe procedohet përmes organeve qeveritare. Rregullimi i tanishëm ligjor nuk është në përputhje me kërkesat e SNISA 1 dhe 10.</p> <p>Me Ligjin për AP, punonjësit në fushën e auditimit trajtohen si nëpunës publik, kurse punonjësit në shërbimet administrative kanë statusin e nëpunësit civil. Ky rregullim dualist e bënë të vështirë menaxhimin e burimeve njerëzore dhe veçanërisht për nëpunësit civil duhet aplikuar rregullat që miratohen dhe administrohen drejtpërdrejt nga organet qeveritare. Për këtë arsye udhëheqja e dokumentacionit dhe dosjeve të personelit duhet të bëhet sipas dy sistemeve ligjore. Ky rregullim ligjor ka ndikim në përcaktimin e strukturës organizative të ZKA-së përkundër faktit që sipas ligjit, AP me akte të brendshme e përcakton strukturën organizative.</p>

B. MANDATI

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
<p>3. Mos-harmonizimi i ligjeve të subjekteve të cilat çështjen e auditimit e kanë trajtuar me ligj të veçantë, me mandatin kushtetues dhe ligjor të AP</p>	<p>Ekziston një paqartësi për auditimin e disa subjekteve që çështjen e auditimit e kanë trajtuar me ligj të veçantë dhe në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat e Ligjit për AP (BQK, AKI, RTK, FKPK)³. Për më tepër Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP, Ligjin për Ndërmarrjet publike, lidhur me mandatin e auditimit të Auditorit të Përgjithshëm dhe afatet kohore për raportim financiar.</p>
<p>4. Detyrimi ligjor që auditimi i rregullsisë të kryhet në baza të rregullta vjetore për çdo organizatë buxhetore</p>	<p>Detyrimi ligjor që auditimi i rregullsisë të kryhet në baza të rregullta vjetore për çdo organizatë buxhetore, pavarësisht madhësisë së buxhetit dhe kompleksitetit të detyrave, e sjellë në vështirësi ZKA-në që të mbuloj llojet tjera të auditimeve, në bazë të vlerësimit të rrezikut.</p>

Vlerësimi i ZKA-së nga palët e treta

✓ Raporti i SIGMA-s 2017

E vlerëson ZKA-në me notën 4 nga 5 në treguesin “Pavarësia e institucionit suprem të auditimit”. Sipas këtij Raporti, qytetarët e Kosovës besojnë që ZKA mund të sjellë rezultate pozitive në fushën e menaxhimit financiar në Kosovë (shih: <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Kosovo.pdf>, referuar më 23.12.2017).

✓ Barometri i Ballkanit për vitin 2017

Anketat e bëra nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) tregojnë që 48% e qytetarëve pajtohen që ZKA është e pavarur nga ndikimi politik, që rangon ZKA-në në pozitën e dytë në rajon (ku mesatarja është 31%) (shih: https://www.rcc.int/seeds/files/RCC_BalkanBarometer_PublicOpinion_2017.pdf, referuar më 23.12.2017).

³ BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Intelgjencës, RTK – Radio Televizioni I Kosovës, FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

FUSHA 2. BURIMET NJERËZORE

Ky domen ka katër elemente: A) Rekrutimi & mbajtja e personelit; B) Zhvillimi i personelit; C) Mirëqenia dhe D) Menaxhimi i performancës.

2.1 Gjendja e dëshirueshme

ISA duhet të ketë një numër adekuat të personelit *kompetent* dhe *të motivuar* për të përmbushur funksionet e tij në mënyrë efektive (SNISA 200 dhe SNISA 40).

2.2 Boshllëqet e identifikuar

A. REKRUTIMI & MBAJTJA E STAFIT

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
1. Mungesa e kandidatëve me përvojën dhe shkathtësitë e duhura për të plotësuar pozitat e lira për auditorë të performancës	Disa procese të rekrutimit kanë rezultuar pa sukses, për shkak të mungesës së aplikimit të kandidatëve me përvojën dhe shkathtësitë e nevojshme.

B. ZHVILLIMI I PERSONELIT

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
2. Mungon një qasje sistemore dhe gjithëpërfshirëse për planifikimin dhe zhvillimin e edukimit profesional dhe trajnimeve, që bazohet në vlerësimin e nevojave, në baza të rregullta	Mungon një metodologji gjithëpërfshirëse për edukimin profesional dhe trajnimet si dhe definimi i qartë i përgjegjësive për planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e tyre.

C. MIRËQENIA

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
3. Mungon programi për kujdesin ndaj mirëqenies së personelit	ZKA nuk ka program për të rritur mirëqenien e stafit, nuk ka sigurim shëndetësor, hapësirë për rekreacion, etj.

D. MENAXHIMI I PERFORMANCËS

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
4. Mungesa e një kornize rregullative më të avancuar për menaxhimin dhe vlerësimin e performancës	Korniza rregullative për menaxhimin e performancës nuk ofron siguri për një proces me integritet dhe në pajtim me qëllimin e kryerjes së vlerësimit të performancës. Poashtu, zbatimi i dy sistemeve të menaxhimit dhe vlerësimit të performancës e vështirëson menaxhimin e këtij procesi në aspektin e unifikimit të standardeve, por edhe në aspektin e menaxhimit administrativ.

FUSHA 3. METODOLOGJIA DHE STANDARDET E AUDITIMIT

Ky domen ka katër elemente: A) Standardet; B) Doracakët dhe udhëzuesit e tjerë; C) Mjetet dhe D) Sigurimi i cilësisë në auditim.

3.1 Gjendja e dëshirueshme

Proceset audituese të ISA duhet të *bazohen* në Standardet e Auditimit të INTOSAI dhe praktikat e mira ndërkombëtare (p.sh. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit) deri në masën që janë të aplikueshme sipas legjislacionit kombëtar (SNISA 100 dhe SNISA 200).

3.2 Boshllëqet e identifikuara

A. STANDARDET

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
1. Nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të personelit për përcjelljen dhe adaptimin e standardeve të reja dhe për të siguruar që auditimet janë kryer në përputhje me standardet e përshtatura nga ISA	Personeli i Departamentit për Metodologji, Standarde dhe Zhvillim (DMSZH) dhe trupi auditues ka nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave profesionale për përcjelljen e ndryshimeve në SNISA dhe zhvillimin e standardeve të reja dhe për të siguruar që auditimet janë kryer në përputhje me standardet e përshtatura nga ISA.

B. DORACAKËT DHE UDHËZUESIT E TJERË

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
2. Nevoja për përditësimin e doracakut për auditime të rregullsisë	<p>Ka hapësirë për përmirësimin e doracakut në drejtim të metodologjisë udhëzuese, dizajnit dhe përzgjedhjes, si dhe mundësimin e proceseve koherente dhe solide analitike. Politikat dhe procedurat mund të bëhen më eksplicite dhe pedagogjike për t'u zbatuar nga punonjësit e ZKA në të gjitha nivelet përkatëse.</p> <p>Gjatë auditimit të rregullsisë kryhen edhe teste të pajtueshmërisë, megjithatë, mungon udhëzimi për auditime të pajtueshmërisë, përfshirë këtu edhe dhënien e opinionit.</p> <p>Përditësimi i Doracakut ka të bëjë edhe me auditimin e Ndërmarrjeve Publike dhe me aktivitetet kundër mashtimit apo korrupsionit.</p>
3. Nevoja për përditësimin e doracakut për auditime të performancës. Poashtu mungon Udhëzuesi për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së auditimeve të performancës	Doracaku për auditime të performancës ka nevojë të përditësohet. Doracaku aktual nuk siguron mbështetje të duhur për auditorët si dhe mungon udhëzuesi për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së AP. Kjo ndikon në shumë aspekte të zbatimit të auditimeve të performancës.

4. Mungesa e udhëzimeve adekuate dhe të letrave të punës që ndërlidhen me auditimet e TI

Për auditime të TI, mungon një kornizë formale e udhëzimeve dhe letrave të punës. Poashtu duhet të zhvillohen më tej kapacitetet njerëzore dhe profesionale.

C. MJETET

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
5. Mungesa e softuerit per auditim	ZKA nuk ka program elektronik të auditimit i cili do të mundësonte kryerjen e auditimit në mënyrë më efikase dhe efektive. Përdorimi i programeve të ndryshme në dokumentimin e punës audituese dhe bartja manuale e të dhënave, ka bërë që të krijohen letra të shumta të punës të cilat ndikojnë në efikasitetin e punës. Për më shumë, ky lloj sistemi i letrave të punës pamundëson rishikimin apo kontrollin e cilësisë online dhe gjurmët e rishikimit nuk evidentohen në mënyrë elektronike - ato duhet të ruhen në mënyrë manuale gjatë tërë kohës.
6. Përdorimi i kufizuar i softuerit IDEA	Edhe pse ZKA e ka në funksion softverin IDEA, ai nuk përdoret në masë të duhur nga auditorët, të cilët do të përfitonin për të bërë analiza të ndryshme dhe mostrim.

D. SIGURIMI I CILËSISË NË AUDITIM

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
7. Mungesa e një sistemi formal për sigurimin e cilësisë për auditimet e performancës	Nuk është vendosur një procedurë formale sistematike për sigurimin e cilësisë së auditimeve të performancës.
8. Nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë për auditimet e rregullsisë	ZKA ka sistem të mirë të sigurimit të cilësisë së auditimeve të rregullsisë, megjithatë ky sistem duhet të zhvillohet edhe më tutje, me qëllim që të sfidohen vendimet e auditimit, duke identifikuar praktika të mira.

FUSHA 4. QEVERISJA E BRENDSHME DHE ETIKA

Ky domen ka gjashtë elemente kryesore: A) Planifikimi strategjik & operativ; B) Komunikimi i brendshëm; C) Llogaridhënia; D) Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes; E) Përmirësimi i vazhdueshëm dhe F) Kontrollat e brendshme

4.1 Gjendja e dëshirueshme

Menaxhmenti i lartë i ISA duhet të siguroj që mekanizmat e vendim-marrjes dhe kontrollit funksionojnë në mënyrë *ekonomike, efikase dhe efektive* dhe shërben si organizatë model në promovimin e qeverisjes së mirë (SNISA 100 dhe SNISA 30).

4.2 Boshllëqet e identifikuara

A. PLANIFIKIMI STRATEGJIK & PLANI OPERATIV

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
1. Mungesa e një sistemi për vlerësimin dhe monitorimin vjetor të progresit kundrejt planit strategjik dhe planit vjetor të punës	Nuk është vendosur një sistem për monitorimin dhe vlerësimin e progresit në zbatimin e planin strategjik - sistem për matjen e performancës.

B. KOMUNIKIMI I BRENDSHËM

Nuk është identifikuar ndonjë boshllëk për këtë element.

C. LLOGARIDHËNIA

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
2. Mos angazhimi i ndonjë ISA partner (apo ndonjë organizate tjetër) për të kryer një vlerësim profesional të pavarur të punës së ZKA-së (peer review)	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë ka për qëllim të shqyrtojë dhe vlerësojë sistemin e kontrollit të cilësisë, duke përfshirë një rishikim të një mostre të punës së përfunduar nga tërësia e auditimeve të kryera. Për këtë arsye mund të konsiderohet angazhimi i një ISA partner, për të kryer një shqyrtim të pavarur të sistemit të përgjithshëm të kontrollit të cilësisë (peer review, SNISA 40), përfshirë edhe aktivitete jo-audituese.

D. KODI I ETIKËS DHE MIRËSJELLJES

Nuk është identifikuar ndonjë boshllëk për këtë element.

E. PËRMIRËSIMET E VAZHDUESHME

Nuk është identifikuar ndonjë boshllëk për këtë element.

F. KONTROLLET E BRENDSHME

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
<i>3. Mungesa të rëndësishme në fushën e administratës me ndikim në kontrollet e brendshme</i>	<p>Mos përshtatja e plotë sipas funksioneve administrative dhe mos plotësimi i pozitave të caktuara të punës.</p> <p>Praktikat e brendshme të personelit të financave në monitorim dhe rishikim të rregullt të buxhetit kanë nevojë për përmirësim për të mbështetur ZKA-në në përmbushjen e planit vjetor.</p>

FUSHA 5. PËRKRAHJA KORPORATIVE

Ky domen ka katër elemente: A) Burimet monetare – buxheti; B) Burimet material; C) Teknologjia dhe D) Shërbimet përkrahëse

5.1 Gjendja e dëshirueshme

ISA duhet t'i menaxhoj burimet financiare në nivel optimal, për të siguruar ofrimin e shërbimeve përkrahëse, aseteve dhe teknologjisë që sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve kryesore. ZKA duhet të posedoj burimet e nevojshme dhe të arsyeshme njerëzore, materiale dhe monetare ku organi ekzekutiv nuk duhet ta kontrolloj apo udhëheq qasjen e drejtpërdrejtë ndaj këtyre burimeve. ISA-të menaxhojnë buxhetin e vet dhe bëjnë alokimin e tij në mënyrë të duhur (Deklarata e Meksikës).

5.2 Boshllëqet e identifikuar

A. BURIMET MONETARE – BUXHETI

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
1. Sfidat në procesin e administrimit të buxhetit	<p>Menaxhimi i buxhetit ndërlidhur me administrimin e sistemit nga MF, karakterizohet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vështirësi në burime të alokuara sipas kërkesës së ZKA; - kufizime të shpeshta në SIMFK për zotime dhe ekzekutimin e pagesave; - shkurtime buxhetore nga MF. <p>Menaxhimi i brendshëm i buxhetit kërkon përditësimin e procedurave për planifikimin e buxhetit.</p>

B. BURIMET MATERIALE

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
2. Mungesa e hapësirës adekuate për zhvillimin e veprimtarisë	Hapësira e objektit ekzistues është e pamjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë. ZKA ka mungesë hapësire për ta akomoduar stafin si dhe ka mungesë të sallave për trajnim dhe mungesë të pajisjeve adekuate për mbarëvajtjen e trajnimit.
3. Mungesa e mjeteve të mjaftueshme të transportit për kryerjen e veprimtarisë	ZKA ka mungesë të veturave zyrtare për të siguruar transport për auditorët për të mbuluar auditimin në të gjithë territorin e vendit. Ndërkaq, transporti publik nuk është i përshtatshëm dhe nuk përmbush të gjitha nevojat e ZKA-së. Kjo bën që auditorët e ZKA-së të përdorin veturat private për qëllime zyrtare.

C. TEKNOLOGJIA

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
4. Mungesa e një strategjie për zhvillimin e TI dhe procedurave për menaxhimin e pajisjeve të TI-së	Mungon strategjia për zhvillimin e TI dhe procedurave për menaxhimin e pajisjeve të TI.

D. MBESHTETJA ADMINISTRATIVE

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
5. Mungesa e masave dhe mjeteve të nevojshme për sigurinë e plotë në punë	Në objektin aktual mungojnë shkallët emergjente, hidrantët, pajisjet sinjalizuese dhe alarmuese etj.
6. Mungesa e burimeve njerëzore për menaxhimin e ngjarjeve (seminareve, konferencave, prezantimeve, etj) dhe shërbimeve protokolare	Mungon personeli i nevojshëm për menaxhimin e ngjarjeve (seminareve, konferencave, prezantimeve, etj) dhe për shërbime protokolare. Kjo e vështirëson organizimin e aktiviteteve të që kanë për qëllim përmirësimin e marrëdhënieve me publikun.

FUSHA 6. MARRËDHËNIET ME PALËT E INTERESIT

Ky domen ka dy elemente: A) Pritjet e palëve të interesit, dhe B) Komunikimi me palët e jashtme

6.1 Gjendja e dëshirueshme

ISA duhet të krijoj dhe mirëmbaj marrëdhënie pune dhe komunikim efektiv me palët kryesore të interesit në mënyrë që të siguroj ndikim më të madh të raporteve të auditimit dhe të shërbimeve tjera të ISA (SNISA 20 dhe 12).

6.2 Boshllëqet e identifikuar

A. PRITJET E PALËVE TË INTERESIT DHE KOMUNIKIMI ME PALËT E JASHTME

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
<p>1. Mungon Strategjia / politika e komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit dhe burimet njerëzore për komunikim me publikun</p>	<p>Mungon Strategjia/politika e komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit e cila do të ndihmonte ZKA-në të zhvilloj një komunikim më efektiv. Poashtu, mungon edhe personeli i nevojshëm për komunikim me publikun.</p>
<p>2. Mungesa e një fushate gjithëpërfshirëse komunikimi dhe edukimi për mandatin dhe rolin e ZKA-së në menaxhimin e financave publike</p>	<p>Në përgjithësi vërehet një mungesë e njohurive dhe informatave nga publiku i gjerë dhe palët e interesit për mandatin, rolin dhe kontributin e ZKA-së në menaxhimin e financave publike. Ka munguar një fushatë gjithëpërfshirëse komunikimi dhe edukimi nga ZKA.</p>
<p>3. Mungesa e anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare dhe rajonale të auditimit në sektorin publik</p>	<p>Mungesa e anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare dhe rajonale të auditimit në sektorin publik (INTOSAI, EUROSAI) i pamundëson ZKA-së që të përfitojë nga programet e ndryshme për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe përcjelljen e ndryshimeve të standardeve dhe zbatimin e tyre me kohë.</p>

Përfitimet e bashkëpunimit të ZKA-së me qytetarët dhe OSHC janë të shumëta:

- Qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të ndihmojnë ZKA-në për të identifikuar fushat e mundshme të keqmenaxhimit, joefikasitetit dhe të korrupsionit. Poashtu, qytetarët mund të kontribuojnë në procesin e auditimit me informata relevante;
- Organizatat e shoqërisë civile mund të bëjnë hetime dhe ekzaminime shtesë mbi bazën e të gjeturave të auditimit;
- Qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të rrisin presionin tek legjislativi dhe subjektet e audituara për të zbatuar rekomandimet e auditimit;
- Qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të ndihmojnë duke monitoruar veprimet e qeverisë dhe të subjekteve tjera të audituara në zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe vendimeve përkatëse të ndërmarra nga komisionet parlamentare;
- ZKA mund t'u ofrojë qytetarëve informata relevante në mënyrë që ata të marrin pjesë aktive në debatet publike dhe të kërkojnë llogaridhënie nga zvrtrtarët publik.

FUSHA 7. REZULTATET

7.1 Gjendja e dëshirueshme

ISA duhet të gjeneroj raporte auditimi dhe t'i ofroj shërbimet e saj bazuar në mandatin e vet dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara, në mënyrë që të arrij ndikimin e dëshiruar në llogaridhënie dhe transparencën në sektorin publik dhe menaxhimin më të mirë të burimeve publike.

7.2 Boshllëqet e identifikuar

Emërtimi i mungesës	Përshkrimi i mungesës
1. Ekziston një nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit mbetet ende në nivel modest. Në disa raste vërehet mungesë e kapaciteteve, por edhe e përkushtimit të duhur nga menaxhmenti i entiteteve të audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Për këtë arsye një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të auditimit nuk zbatohen dhe disa prej tyre përsëriten nga viti në vit.
2. Mungesa e një mekanizmi efektiv për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve dhe matjen e ndikimit të tyre praktik	ZKA nuk ka një mekanizëm efektiv për përcjelljen e rekomandimeve të dhëna dhe matjen e ndikimit të tyre praktik në sektorin publik.
3. Mos përdorimi i raporteve të ZKA-së si input për dëgjimet buxhetore me rastin e hartimit të ligjit për buxhetin vjetor	Me rastin e dëgjimeve dhe debateve buxhetore për projekt-buxhetin vjetor nuk merren parasysh raportet e auditimit dhe në këtë mënyrë nuk motivohen performuesit e mirë (p.sh. organizatat buxhetore që kanë bërë progres në zbatimin e rekomandimeve të auditimit).
4. Mungesa e sinkronizimit të kohës së publikimit të Raportit Vjetor të Auditimit dhe të aprovimit të Raportit Financiar Vjetor të Qeverisë	Nuk ka sinkronizim të kohës së publikimit të Raportit Vjetor të Auditimit (31 gusht) dhe të aprovimit të Raportit Financiar Vjetor të Qeverisë (i cili dorëzohet për aprovim në Kuvend më 31 mars). Kjo paraqet një pengesë për ndikimin më të madh të punës së ZKA-së.
5. Mungon shqyrtimi i rregullt i raporteve të auditimit të performancës nga komisionet përkatëse parlamentare	Raportet e auditimit të performancës nuk shqyrtohen në komisionet parlamentare funksionale (me përjashtim të KMFP) ashtu sikur ndodhë me raportet e auditimit të rregullsisë.
6. Mungon feedback-u formal nga entitetet e audituara për punën e ZKA-së	ZKA nuk ka zhvilluar një procedurë formale të pranimit të feedback-ut nga entitetet e audituara.

SHTOJCA 2: FJALORI I SHPREHJEVE

Fjalori i shprehjeve

AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
EPS	Ekipi për Planifikim Strategjik
GAO	Institucioni Suprem i Auditimit i SHBA-ve
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ONISA/INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IDI	Iniciativa për Zhvillim e ONISA/INTOSAI
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
KBF	Komisioni për Buxhet dhe Financa
NP	Ndërmarrja publike
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
OB	Organizata Buxhetore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ECA	Gjykata Evropiane e Auditimit
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNAO	Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

<http://www.zka-rks.org>